



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



**RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KËSHILLIT
SHTETËROR TË CILËSISË DHE I AGJENCISË SË
KOSOVËS PËR AKREDITIM PËR VITIN 2021**

Prishtinë, 2022

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	4
LISTA E FIGURAVE	5
LISTA E TABELAVE	5
1. HYRJE.....	6
2. AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM (AKA)	6
3. KËSHILLI SHTETËROR I CILËSISË (KShC)	8
3.1 Funkcionalizimi i KShC pas ratifikimit të anëtarëve të rinjë në Kuvendin e Kosovës	9
4. MBLEDHJET E KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË DHE VENDIMET NË VITIN 2021	10
5. PROCESI I VLERËSIMIT DHE AKREDITIMIT TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË NË VITIN 2020/2021	11
5.1 Akreditimi institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë.....	13
5.1.1. Akreditimi institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë publik.....	13
5.1.2. Akreditimi institucional i Institucioneve të Arsimit të lartë privat	14
5.2.1. Akreditimi i programeve të studimit në Institucionet e Arsimit të Lartë publik	14
5.2.2. Akreditimi i programeve të studimit në Institucionet e Arsimit të Lartë privat	15
6. KOMISIONI I ANKESAVE.....	16
7. SIGURIMI I BRENDSHËM I CILËSISË SË PUNËS SË AKA.....	16
8. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR, PARTNERITETI DHE PROJEKTET ...	17
9. AKTIVITETE KRYESORE TË AGJENCISË E AKREDITIMIT	18
9.1 AKA ka përfunduar me sukses proceset e akreditimit për 239 programe studimore.....	18
9.2 Angazhohen 81 ekspertë ndërkombëtarë për vlerësim	19
9.3 Aprovimi i Planit Strategjik të AKA-së 2021-2025	19
9.4 Binjakëzimi ndërmjet Agjencive të Akreditimit të Kosovës dhe Austrisë	20
9.5 Studimi i fizibilitetit për dixhitalizimin dhe automatizimin e proceseve në AKA	20
9.6 Nga KShC është aprovuar metodologjia për analiza tematike	21
9.7 Nga KShC është aprovuar Udhëzuesi për Vlerësim të Brendshëm të stafit të AKA	21
9.8 Nga KShC është aprovuar Metodologjia e Monitorimit dhe procedurave pasakredituese	22

9.9 Vërtetimet për akreditim tani lëshohen online.....	22
9.10 Nga KShC është aprovuar Manuali për ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit.....	23
9.11 Është lansuar ueb faqja e re e AKA-së dhe profili zyrtar në Facebook	23
9.12. ASHI garanton sigurinë kibernetike të AKA-së	23
9.13 Ndërlidhja e Platformës e-Akreditimi me Administratën Tatimore.....	23
9.14 Publikohen të gjitha vendimet dhe raportet e ekspertëve ndërkombëtarë	24
9.15 AKA publikon listat me programet e akredituara dhe spotin informues	24
10. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE E PARTNERË VENDORË.....	24
10.1 Miratimi i Ligjit për AKA-në në Qeveri	24
10.2 Plani Dinamik për kthim në ENQA dhe EQAR	25
10.3 Vizitat e KShC dhe AKA në të gjitha institucionet e arsimit të lartë	25
10.4 Ndërtesa e re e AKA-së.....	25
10.5 Rekrutimi i stafit	25
10.6 Bashkëpunimi me shoqërinë civile	25
10.7 Bashkëpunimi me Avokaturën Shtetërore	26
11. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE E PARTNERË NDËRKOMBËTARË	26
11.1 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën.....	26
11.2 Rishikimi i standardeve në nivelin bachelor dhe master	27
11.3 AKA fiton grant nga Ambasada Amerikane për përfshirjen e studentëve në vendimmarrje.....	27
11.4 CEENQA prezanton suksesin e AKA-së në procesin e digjitalizimit të shërbimeve.....	27
11.5 AKA dhe Asociacioni amerikan ATMAE bashkëpunojnë për nxitjen e cilësisë në arsimin e lartë	27
11.6 AKA mbështet nga QAINT për hartimin e KSAC për lehtësimin e klasifikimit të fushave të studimit.....	28
ANEKSET	29

SHKURTESAT

ADA – Agjencia Austriake për Zhvillim

AKA - Agjencia e Kosovës për Akreditim

CEENQA - Rrjeti i Evropës Qendrore dhe Lindore për Sigurimin e Cilësisë

ENQA - Rrjeti Evropian për Sigurimin e Cilësisë

EQAR - Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë

ESG - Standardet dhe Udhëzuesit Evropian për Sigurimin e Cilësisë

HERAS - Higher Education, Research and Applied Science Plus

IAL - Institucion i Arsimit të Lartë

IAL publik - Institucionet e Arsimit të Lartë të financuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës

IAL privat - Institucionet e Arsimit të Lartë të vet-financuara

INQAAHE - Rrjeti Ndërkombëtar i Agjencive për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë

KA - Komisioni i Ankesave i cili shqyrton ankesat e pranuar nga IAL për vendimet e KSHC-së

KKK – Korniza Kombëtare e Kualifikimeve

KShC - Këshilli Shtetëror i Cilësisë

Ligji për AL - Ligji për Arsimin e Lartë

MASHTI - Ministria e Arsimit, Shkencës , Teknologjisë dhe Inovacionit

QAIN T – Projekti Cilësi, Llogaridhënie, Integritet dhe Transparencë në Arsimin e Lartë

RVV – Raporti i Vetëvlerësimit

SC - Sigurimi i Cilësisë

UA - Udhëzim Administrativ

WUS Kosova - World University Service Kosovë

KSAC – Kodi i fushave të Studimit për Kosove (Kosovo Subject Area Code)

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Numri i institucioneve te akredituara	13
Figura 2: Institucionet private të arsimit të lartë dhe vendimet e KSHC-së	14
Figura 3: Vleresimi i programeve të institucioneve publike të arsimit të lartë varesisht nivelit te studimit	15
Figura 4: Programe akademike të institucioneve private të arsimit të lartë.....	15
Figura 5: Vleresimi i programeve të institucioneve private të arsimit të lartë varesisht nivelit te studimit	15
Figura 6: Anëtarësimi dhe bashkëpunimi i AKA me partnerët dhe rrjetet ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë	17
Figura 7: Vendimet e Këshilli Shtetëror të Cilësisë për 239 programet akademike.....	18

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Aktivitetet e KSHC-së menjëherë pas aktivizimit të anëtarëve të rinjë.....	9
Tabela 2: Lista e mbledhjeve të mbajtura për vitin 2021	11
Tabela 3: Institucionet publike të Arsimit të lartë që iu nënshtruan akreditimit institucional në vitin 2021 dhe vendimi i KSHC-së për secilën prej tyre.	13
Tabela 4: Institucionet private të arsimit të lartë që iu nënshtruan akreditimit në vitin 2021 dhe vendimet e KSHC-së për secilën prej tyre.	14

1. HYRJE

Ky dokument është përpiluar më qëllim të raportimit vjetor të punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë dhe i Agjencisë së Kosovës për Akreditim për vitin 2021.

Brenda këtij raporti janë të vendosura informatat mbi aktivitetet e Këshillit Shtetëror të Cilësisë dhe Agjencisë së Kosovës për Akreditim. Aktivitetet kryesisht ndërlidhen me proceset e vlerësimit dhe akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programet tyre të studimit të Nivelit të V, Bachelor, Master dhe Doktoratës, për vitin 2020/2021.

Për më shumë, dokumenti ofron informata mbi zhvillimet e fundit që kontribuojnë në sigurimin e brëndshëm të cilësisë së punës së Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe Këshillit Shtetëror të Cilësisë, bashkëpunimit me institucione partnere kombëtare dhe ndërkombëtare.

2. AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM (AKA)

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) është agjenci publike, e pavarur, e cila bën akreditimin dhe ri akreditimin e institucioneve publike dhe private të Arsimit të Lartë në Kosovë dhe programeve të tyre të studimit. Ajo u themelua nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në vitin 2008, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë Nr. 2003/14.¹

Përmes procesit të akreditimit, AKA mbështet zhvillimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe në këtë mënyrë siguron shoqërinë se ofertat për arsim të lartë në Kosovë përkojnë me standardet e krahasueshme ndërkombëtare.

Baza ligjore për aktivitetin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) janë Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë (Nr. 04/L-037, datë 31.08.2011) dhe Udhëzimi Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 15/2018)² i cili gjatë vitit 2019 pësoi tri herë ndryshime nga MASHT (UA 02/2019³; UA 08/2019⁴, gjegjësisht UA 13/2019)⁵

Konform nenit 7. të LAL (Nr. 04/L-037), AKA realizon përgjegjësitë e saj, që janë: Këshillimin me Ministrinë lidhur me kërkesat e institucioneve për licencimin e kurseve apo programeve të tyre; inspektimin e bartësve të arsimit të lartë dhe këshillimin me Ministrinë lidhur me dhënien, ndryshimin ose anulimin e licencave; kryerjen e kontroleve periodike mbi cilësinë e bartësve të licencuar të arsimit të lartë dhe marrjen e vendimit për akreditimin apo ri akreditimin e tyre, kryerjen e vlerësimeve periodike të cilësisë së programeve të ofruara nga bartësit e akredituar të arsimit të lartë.

¹ <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/2-ligji-per-arsimin-e-larte.pdf>

² <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/10/ilovepdf-merged.pdf>

³ <https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/07/4dd5f6a7-x.pdf>

⁴ <https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/05/ua-masht-08-2019-per-ndryshim-dhe-plotesim-te-ua-nr-15-18.pdf>

⁵ <https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/07/4dd5f6a7-x.pdf>

AKA bën akreditimin në këto nivele:

- Akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë
- Akreditimi i programeve të studimit
- Akreditimi i institucioneve dhe programeve të studimit
- Akreditimi i degëve dhe programeve të studimit të cilat ofrohen në ato degë
- Njohjen/validimin e akreditimit ndërkombëtar

Që nga themelimi i saj, AKA në përputhje me Standardet dhe Udhëzuesit Evropian për Sigurimin e Cilësisë (ESG)⁶ ka zhvilluar të gjitha standardet dhe procedurat për akreditim dhe i ka publikuar ato përmes ueb faqes së saj zyrtare.⁷

Kërkesa për akreditim mund të bëhet nga:

- Vet institucioni i arsimit të lartë për tu vlerësuar në nivel institucional apo të programeve të studimit
- Ministria e arsimit, shkencës, teknologjisë dhe inovacionit (MASHTI)
- Këshilli Shtetëror i Cilësisë i AKA, në raste të veçanta.

Me qëllim të zhvillimit të një procesi transparent të akreditimit, AKA ka përgatitur të gjitha dokumentet e nevojshme mbi procedurat e akreditimit të cilat mund të shfrytëzohen nga IAL-ët, sikurse janë: Standardet e AKA-së, Udhëzuesit e AKA-së për Hartimin e Raportit të Vet-vlerësimit (RVV) për vlerësimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit, përkatësisht Manualin e Akreditimit⁸. Këto dokumente kanë shërbyer jo vetëm si udhëzues për institucionet e arsimit të lartë për qëllim të procesit të akreditimit por edhe si udhëzues për sigurimin dhe menaxhimin e brendshëm të cilësisë.

AKA përbëhet nga struktura administrative e saj, e cila udhëhiqet nga Drejtori, dhe nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) i cili është organ qeverisës dhe vendim-marrës i AKA. Struktura administrative e AKA momentalisht ka të punësuar drejtorin dhe 8 zyrtarë.

Ndërhyrjet e shpeshta të politikës në emërimin dhe shkarkimin e Drejtorit të AKA, bënë që ajo të funksionojë me U.D drejtor gjerë në mars të vitit 2020. Këto ndërrime të shpeshta, padyshim, kanë ndikuar edhe në efikasitetin e punës së AKA-ës, posaçërisht në kohën kur ajo u përjashtua nga Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë- EQAR në vitin 2018,⁹ dhe humbi statusin e anëtarit të plotë në Rrjetin Evropian të Sigurimit të Cilësisë- ENQA¹⁰, pas një rivlerësimi në vitin 2019.

6. https://www.enqa.eu/wp-content/uploads/2015/11/ESG_2015.pdf

7 <https://akreditimi.rks-gov.net/guidelines/>

8. <https://akreditimi.rks-gov.net/accreditation/standards/>

⁹ EQAR https://www.eqar.eu/assets/uploads/2018/04/T_180313_KAA_PublicStatement.pdf

¹⁰ENQA <https://www.enqa.eu/review-database/external-review-report-of-kaa-2/>

3. KËSHILLI SHETËTOR I CILËSISË (KShC)

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) është organ qeverisës i Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe është përgjegjës për marrjen e vendimeve për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit. Veprimtaria e KSHC-së bazohet në Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037.¹¹

Përzgjedhja e anëtarëve të KShC-së përcaktohet sipas dispozitave të Ligjit të Arsimit të Lartë, përkatësisht nenit 7, paragrafi 4 i cili përcakton se “AKA duhet të qeveriset nga një bord i përbërë nga jo më pak se pesë dhe jo më shumë se nëntë persona, të emëruar nga Ministria për një mandat të caktuar, i cili duhet të përbëhet nga radhët e personave të të dy gjinive, që janë aktivë në punën akademike të arsimit të lartë dhe /ose në profesione brenda dhe jashtë Kosovës dhe i cili duhet të ketë të paktën tre persona ('ekspertë ndërkombëtarë'), që nuk janë të punësuar nga asnjë bartës i arsimit të lartë në Kosovë. Ky bord do të quhet Këshilli Shtetëror i Cilësisë i AKA-së. Anëtarët e tij ratifikohen nga Kuvendi. Vendimet apo rekomandimet lidhur me akreditimet, Këshilli i merr me shumicën e votave të anëtarëve të vet. Këshilli i raporton çdo vit Ministrisë dhe Kuvendit lidhur me aktivitetet e veta të akreditimit dhe me përshtatshmërinë e infrastrukturës mbështetëse që ka në dispozicion”.

Përpos Ligjit të Arsimit të Lartë, MASHT ka hartuar një Udhëzim të veçantë Administrativ për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të KSHC-së (Nr. 05/2018, dt.15.03.2018).¹² Lista e përzgjedhur e të nominuarve ratifikohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ky UA mundëson përzgjedhjen e anëtarëve të KSHC-së mbi bazën e kriterëve dhe procedurave profesionale dhe transparente, të cilat janë aplikuar për herë të parë në Kosovë që nga themelimi i Agjencisë së Akreditimit. Puna e KSHC-së bazohet në Rregulloren mbi Punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë(Nr. 621/18D, dt.12.06.2018)¹³, i cili është dokument i publikuar në ueb faqen e AKA-së. Sipas kësaj rregulloreje, KShC cakton agjendat vjetore për procesin e akreditimit të IAL-ve, aprovon standardet, procedurat dhe kriteret e akreditimit, aprovon Ekipet e ekspertëve të jashtëm, të propozuara nga drejtori i AKA, merr vendimet për akreditim si dhe aprovon Statutin dhe të gjitha Rregulloret e AKA.

¹¹ <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/2-ligji-per-arsimin-e-larte.pdf>

¹² <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/05/ua-nrmasht-06-2018-per-kriteret-dhe-procd-e-emerimit-te-anetareve-te-kshcaka-x.pdf>

¹³ <https://drive.google.com/file/d/0B7etG3bh-SBVVkt4T2j5bmZu0TdYVFN4bFZmMnFwax3Z0tR/view?resourcekey=0-QuhrTz6eTC2uk1Lt0rUjw>

Përbërja e KShC-së në mbledhjen e parë të vitin 2021 ishte si vijon:

- Prof. Dr. Gazmend Luboteni, kryetar
- Prof. Asoc. Dr. Vjollca Krasniqi, nënkryetare
- Prof. Asoc. Dr. Arta Basha - Jakupi
- Dr. Sc. Spec. Rozafa Koliqi-Lila
- Prof. Dr. Magdalena Ziolo
- Prof. Dr. Herbert K. Amato
- Prof. Msc. Jeffery Butel
- Prof. Ass. Dr. Dukagjin Zeka
- Prof.ass. Binak Beqaj-i emëruar nga ministri i MASHT-it

Kurse nga mbledhja e dytë e KShC-së për vitin 2021, e cila ishte edhe mbledhje konstituive, KShC ka vijuar të funksionojë me përbërjen në vijim:

- Prof. Ass. Dr. Hasnije Ilazi, kryetare;
- Prof. Asoc.Dr. Klemen Miklavic, nënkryetar;
- Prof. Ass. Dr. Krenare Pireva-Nuci;
- Prof. Ass. Dr. Rozafa Koliqi-Lila;
- Prof. Ass. Dr. Dukagjin Zeka;
- Prof. Ass. Dr. Gëzim Tosuni;
- Prof. Ass. Dr. Seb Bytyçi;

3.1 Funkcionalizimi i KShC pas ratifikimit të anëtarëve të rinjë në Kuvendin e Kosovës

Pas votimit në Kuvendin e Kosovës në Qershor 2021 është mbajtur mbledhja e parë e Këshillit Shtetëror të Cilësisë e drejtuar nga Ministria Nagavci, me 28 Qershor 2021. KShC në përbërje të re është angazhuar në finalizimin e proceseve të pezulluara nga mos funksionalizimi i Këshillit të mëhershëm, dhe në planifikimin e aktiviteteve me të cilat do të plotësohet vakumi procedural dhe proceset për ngritjen e cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë në harmoni me politikat e grupit E4 (ENQA, EUA, EURASHE and ESU) dhe Standardet dhe udhëzimet për sigurimin e cilësisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG).

Tabela 1: Aktivitetet kryesore të KShC në periudhën korrik –dhjetor 2021

Nr	Përshkrimi	Data
1	Këshilli Shtetëror Cilësisë pas ratifikimit në Kuvendin e Kosovës merr vendim për 239 programe akademike në pritje për akreditim. Programet e akredituara për 2021/2022 janë bashkangjitur në Aneksin 1.	Korrik 2021 Gusht 2021

2	Këshilli Shtetëror i Cilësisë avancoi standardet përmes sqarimeve të Manualit për Akreditim në pikat 3, 4 dhe 5. Në pikën nr 3 të parimeve të përgjithshme të Manualit për Akreditim sqarohen kriteret për akreditimi të programeve të Mjekësisë së Përgjithshme Në pikën nr 4 të parimeve të përgjithshme të Manualit për Akreditim vendosen kriteret për akreditimi të degëve të IAL-ve Në pikën nr 5 të parimeve të përgjithshme të Manualit për Akreditim vendosen kriteret për hulumtim shkencor dhe titujt akademik për bartësit e programeve në nivelin BA/BSc dhe MA/MSc	Shtator 2021
3	Këshilli Shtetëror i Cilësisë instalon frymën e partneriteti me IAL-të për ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë duke vizituar të gjithë IAL-të dhe dëgjuar më përafërm nevojat e tyre. Rekomandim ky edhe nga vlerësimi i fundit i ENQA.	Shtator – Dhjetor 2021
4	Këshilli Shtetëror i Cilësisë raporton në Komisionin për Arsim	Shtator 2021
5	Këshilli Shtetëror i Cilësisë aprovon Planin e Aktiviteteve për vitin 2022, prioriteti kryesor: rikthimi i Agjencisë së Akreditimit në Asociacionin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe Regjistrin Evropian për Rritje të Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR).	Nëntor 2021
6	Këshilli Shtetëror i Cilësisë me ndihmën e Ambasadës Amerikane, përkatësisht programi Fulbright finalizon studimin e fizibilitetit për digjitalizimin dhe automatizimin e proceseve në AKA	Dhjetor 2021
7	Këshilli Shtetëror i Cilësisë me planin e veprimit inicion komunikimin në mes Agjencionit dhe ENQA	Dhjetor 2021
8	Këshilli Shtetëror i Cilësisë miraton Plani Strategjik të AKA-së 2021-2025	Dhjetor 2021
9	Këshilli Shtetëror i Cilësisë miraton Metodologjinë e Monitorimit	Dhjetor 2021
10	Këshilli Shtetëror i Cilësisë merr pjesë në hartimin e ligjit për Agjencinë e Akreditimit	Dhjetor 2021
11	Këshilli Shtetëror i Cilësisë aprovon manualin e Raportimit Vjetor	Dhjetor 2021

4. MBLEDHJET E KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË DHE VENDIMET NË VITIN 2021

Gjatë vitit 2021, KShC ka mbajtur dhjetë mbledhje, prej tyre nëntë ishin të rregullta kurse një ishte e jashtëzakonshme. Tabela 2 liston mbledhjet e mbajtura sipas radhës.

Tabela 2: Lista e mbledhjeve të mbajtura për vitin 2021

Nr	Data	Komente
1	22.01.2021	Mbledhja e 85-të e KSHC-ës (me përbërjen e vjetër të KSHC-së)
2	21.06.2021, 28.06.2021	Mbledhja e 86-të e KSHC-ës (mbledhje konstituive e përbërjes së re të KSHC-së)
3	07.07.2021	Mbledhja e 87-të e KSHC-së
4	07.09.2021	Mbledhja e 88-të e KSHC-së
5	17.09.2021	Mbledhja e 89-të e KSHC-së
6	21.09.2021	Mbledhja e 90-të e KSHC-së
7	05.10.2021	Mbledhja e 91-të e KSHC-së
8	18.10.2021	Mbledhja e 92-të e KSHC-së (Mbledhje e jashtëzakonshme për miratimin e raporteve të vlerësimit për programet e doktoratës)
9	02.11.2021,	Mbledhja e 93-të e KSHC-së
10	21.12.2021	Mbledhja e 94-të e KSHC-së.

5. PROCESI I VLERËSIMIT DHE AKREDITIMIT TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË NË VITIN 2020/2021

Vlerësimi institucional dhe i programeve të studimit është një aktivitet periodik i AKA-së. Ky proces bazohet në vlerësimin e dokumenteve të dorëzuara nga institucioni aplikues (Raporti i vetëvlerësimit) dhe në bazë të të gjeturave gjatë vizitës në terren me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit. Bazuar në procedurat e publikuara të AKA-së, çdo IAL duhet të dëshmojë se plotëson kriteret e akreditimit me qëllim që të marrë akreditimin.

Bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për akreditimin e institucioneve të Arsimit të Lartë (Nr. 15/2018), çdo IAL që paraqet kërkesë për akreditimi/ri akreditim institucional të një apo më shumë programeve të studimit, së bashku me Aplikacionin/kërkesën duhet të paraqesë edhe listën e stafit akademik, të cilët paraprakisht janë deklaruar në AKA përmes platformës e-akreditimi se janë të angazhuar në atë IAL, në programin përkatës për vitin e caktuar akademik. Aplikacioni, së bashku me listën e stafit i nënshtrohet vlerësimit të përmbushjes së kriterëve formale dhe nëse aprovohet nga KSHC, ai përfshihet në agjendën vjetore të AKA për vlerësim. Në rast të vlerësimit negativ të aplikacionit nga KSHC, ai refuzohet dhe nuk i nënshtrohet vlerësimit. IAL, aplikacionet dhe listat e stafit të të cilit janë aprovuar, duhet të sjellë në AKA Raportin e Vetëvlerësimit (RVV) i cili do të dërgohet ekipit vlerësues të jashtëm në një afat kohor të caktuar para vizitës, konkretisht para vlerësimit në distancë nëpërmes video konferencës.

Në vitin 2021 AKA realizoi procesin e vlerësimit dhe akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit mbi bazën e standardeve të rishikuara në vitin 2019 dhe Manualit të ri të Akreditimit në të cilën duhet të bazohen IAL gjatë hartimit të RVV. Standardet e reja synojnë avancimin e cilësisë së përgjithshme të IAL-ve në Kosovë dhe fokusohen më shumë në konsolidimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë së tyre.

Ashtu si në vitin 2020, viti 2021 ishte vit jo i zakonshëm për shkak të pandemisë COVID-19. Kjo gjendje ndikoi që edhe AKA të vazhdojë punën e vet në përputhje me rrethanat dhe rekomandimet e Qeverisë së Kosovës për luftimin dhe parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19. Bazuar në vendimin e KSHC-së të 19 prillit 2020 Agjencia e Kosovës për Akreditim vazhdoi të zhvillojë procesin e akreditimit në distancë. Vendimi përfundimtar për lejimin e akreditimit në distancë është marrë nga ish-ministrja e Arsimit, (Ref: 35/018 Datd:07.05.2020).¹⁴ Ky Vendim rregullon procedurat e vlerësimit të jashtëm nga vlerësuesit ndërkombëtarë përmes video konferencës, gjatë periudhës në të cilën janë në fuqi masat e aplikuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës sipas paragrafit 1.2 të vendimit Nr.01/07, të datës 11.03.2020¹⁵, me qëllim të menaxhimit të rrethanave emergjente të krijuara nga pandemia COVID 19, me të cilin, ndër të tjera, është pezulluar përkohësisht transporti ajror dhe tokësor ndërkombëtar duke pamundësuar ardhjen e vlerësuesve ndërkombëtarë për procesin e akreditimit dhe ri-akreditimit në Republikën e Kosovës.

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), gjatë këtij vitit 2021 ka arritur të përfundojë me sukses procesin e akreditimit për 239 programe akademike dhe 9 procese të akreditimit në nivel të institucioneve të arsimit të lartë. Prej këtij numri 199 raporte/vendime janë pozitive për akreditim, ndërsa 40 janë rekomanduar që të mos akreditohen.

Përkundër shumë vështirësive që ka paraqitur pandemia COVID-19, ekipi i AKA-së arriti të kryejë të gjitha vizitat në terren brenda afatit ligjor, dhe i ka mundur Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) që të marrë vendimet në lidhje me akreditimin me kohë.

Vizitat në terren janë zhvilluar nga ekspertët ndërkombëtarë në distancë (online) por ekipi i AKA-së ka qenë prezentë fizikisht në çdo proces të vlerësimit të jashtëm duke bërë verifikimin e të gjithë personave që kanë qenë të përfshirë në akreditim. Poashtu, është bërë verifikimi fizik i të gjitha informatave, dokumenteve dhe videove të cilat u janë prezantuar ekspertëve ndërkombëtarë.

Ekspertët ndërkombëtarë të angazhuar në procesin e vlerësimit kanë konfirmuar se gjatë vitit 2021 kanë parë zhvillime shumë pozitive në cilësinë e arsimit të lartë në Kosovë.

Gjatë procesit të akreditimit AKA nuk ka pranuar asnjë ankesë nga asnjë institucion i arsimit të lartë, lidhur me procesin e vlerësimit të jashtëm. Ankesat si rëndom kanë ardhur pasi që janë dorëzuar draftet e raporteve të ekspertëve ndërkombëtarë, që në disa raste kanë

¹⁴ <https://akreditimi.rks-gov.net/about-us/dispozitat/dokumente/>

¹⁵ <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2021/04/Vendimet-e-Mbledhjes-se-7-te-te-Qeverise-se-Republikes-se-Kosoves.pdf>

qenë negative për akreditim të programeve të studimit.

Procesi i akreditimit në Kosovë është vlerësuar pozitivisht në raportin e Komisionit Evropian për Kosovën, dhe gjatë takimeve me drejtoreshën e Asociacionit Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe nga Rrjeti i Agjencive të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë të Evropës Qendrore dhe Lindore (CEENQA). Procesi i akreditimit në Kosovë është vlerësuar pozitivisht edhe nga monitoruesit vendorë dhe nga donatorët ndërkombëtarë.

5.1 Akreditimi institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë

Në vitin 2021, AKA realizoi vlerësimin institucional të 11 IAL-ve, prej tyre 2 ishin Universitete publike kurse 9 tjera ishin kolegje private.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) më 21.06.2021 mbajti mbledhjen e rregullt, në të cilën u analizuan dhe votuan raportet e ekspertëve ndërkombëtarë mbi vlerësimin e institucioneve të arsimit të lartë. Siç shihet në Figurën 1, nga gjithsej 11 institucione të vlerësuara, mbi bazën e rekomandimit të ekspertëve ndërkombëtarë, 7 nga këto institucione u ri-akredituan ndërsa 4 të tjera u refuzuan për ri-akreditim (Shih Figurën 2).




Figura 1: Numri i institucioneve të akredituara

Në procesin e vlerësimin institucional të IAL, ishin të angazhuar 9 ekspertë ndërkombëtarë, prej të cilëve 3 ishin studentë ekspertë, ashtu siç kishte rekomanduar ENQA në rekomandimet e saj në Raportin e vlerësimin të AKA në vitin 2019.

5.1.1. Akreditimi institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë publik

Tabela 3: Institucionet publike të Arsimit të lartë që iu nënshtruan akreditimit institucional në vitin 2021 dhe vendimi i KSHC-së për secilën prej tyre.

Nr.	Institucioni	Vendimi i KSHC-së
1	Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”	Akreditohet për 3 vjet
2	Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”	Akreditohet për 3 vjet

Tabela 3, liston institucionet publike të cilat iu nënshtruan akreditimit institucional në vitin 2021. Nga 2 universitetet publike të vlerësuara, Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani” dhe ai i Gjilanit “Kadri Zeka” u akredituan për periudhë 3 vjeçare.

5.1.2. Akreditimi institucional i Institucioneve të Arsimit të lartë privat

Tabela 4: Institucionet private të arsimit të lartë që iu nënshtruan akreditimit në vitin 2021 dhe vendimet e KSHC-së për secilën prej tyre.

Nr.	Institucioni	Vendimi i KSHC-së
1	Kolegji Biznesi (Prishtinë)	Akreditohen për 3 vjet
2	Kolegji Biznesi (Prizren)	Akreditohen për 3 vjet
3	Cactus Education	Nuk akreditohet
4	Kolegji Globus	Nuk akreditohet
5	Kolegji Pjeter Budi	Akreditohen për 3 vjet
6	Akademia Tempulli	Akreditohen për 3 vjet
7	Kolegji UBT (Gjilan)	Nuk akreditohet
8	Kolegji UBT (Gjilan) Pejë	Akreditohen për 3 vjet
9	Kolegji Universi	Nuk akreditohet

Tabela 4, liston institucionet private të cilat iu nënshtruan akreditimit institucional në vitin 2021. Siç shihet në Figurën 3, nga 9 Institucionet private të arsimit të lartë që iu nënshtruan akreditimit institucional në vitin 2021, u akredituan pesë prej tyre. Katër kolegje nuk u akredituan në nivel institucional.




Figura 2: Institucionet private të arsimit të lartë dhe vendimet e KSHC-së

5.2.1. Akreditimi i programeve të studimit në Institucionet e Arsimit të Lartë publik

Nga 140 programe akademike të universiteteve publike që iu nënshtruan vlerësimit për akreditim ose ri akreditim në vitin 2021, 74 ishin të nivelit Bachelor, ku janë përfshirë edhe 2 programe të integruara (Arkitekturë dhe Mjekësi veterinare), 61 të nivelit Master dhe 5 programe të nivelit të doktoratës.

Pas vlerësimit nga ekspertët ndërkombëtarë dhe pas shqyrtimit të raporteve të vlerësimit nga KSHC, nga 140 programe të vlerësuara 124 prej tyre u akredituan (68 të nivelit

Bachelor, 52 të nivelit Master dhe 1 program i nivelit të doktoratës), kurse 16 programe nuk arritën t'i plotësojnë standardet e akreditimit (2 të nivelit Bachelor, 10 të nivelit Master dhe 4 të nivelit të doktoratës). (Shih Figurën 4)




Figura 3: Vleresimi i programeve të institucioneve publike të arsimit të lartë varesisht nivelit te studimit

5.2.2. Akreditimi i programeve të studimit në Institucionet e Arsimit të Lartë privat

Nga 89 programe akademike të institucioneve private të arsimit të lartë që iu nënshtuan vlerësimit për akreditim ose ri akreditim në vitin 2021, 2 ishin programe të nivelit V të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, 63 ishin të nivelit Bachelor dhe 24 të nivelit Master (shih Figura 5).




Figura 4: Programe akademike të institucioneve private të arsimit të lartë

Siç shihet ne Figurën 6, pas vlerësimit nga ekspertët ndërkombëtarë dhe pas shqyrtimit të raporteve të vlerësimit nga KSHC, nga 89 programe të vlerësuara 74 prej tyre u akredituan (54 të nivelit Bachelor dhe 20 të nivelit Master), kurse 15 programe nuk arritën t'i plotësojnë standardet e akreditimit (2 të nivelit V ispas Kornizës Kombëtare të Kualifikimit, 9 të nivelit Bachelor dhe 4 të nivelit Master). (shih tabelën bashkëngjitur)




Figura 5: Vleresimi i programeve të institucioneve private të arsimit të lartë varesisht nivelit te studimit

6. KOMISIONI I ANKESAVE

E drejta ankimore e IAL ndaj vendimeve të KSHC-së është e rregulluar me nenin 22 të UA 15/2018.,¹⁶ sipas të cilit IAL-ët mund të ankohen kundër vendimit të KSHC-së brenda një afati kohor prej 30 ditësh nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KSHC-së për akreditim, procedurë kjo që është në përputhje me Ligjin mbi procedurën Administrative.¹⁷ Funkcionimi i Komisionit të ankesave rregullohet me Rregulloren Nr.2/2019¹⁸ për funksionimin e Komisionit të Ankesave të AKA-së. Ky komision pranon ankesat e IAL-ve dhe brenda një afati 30 ditësh duhet ti shqyrtojë ato dhe të kthejë përgjigje te IAL. Një Komision i pavarur i ankesave u formua në shtator të vitit 2020, dhe përbëhet prej 5 anëtarëve të jashtëm prej të cilëve 3 janë të përhershëm, kurse 2 tjerë janë anëtarë rezervë. Njëri prej anëtarëve të përhershëm është jurist me profesion, me përvojë mbi 10 vjeçare. Mandati i anëtarëve të komisionit është 2 vjet.

Gjatë vitit 2021, Komisioni i Ankesave në AKA ka shqyrtuar gjithësej 22 ankesa te Institucioneve të Arsimit të Lartë.

Përbërja e Komisionit të Ankesave në AKA ishte:

1. Faton Merovci, kryetar (anëtar i përhershëm)
2. Krenare Sogojeva, anëtare e përherëshem
3. Muhamet Qerimi, anëtar i përhershëm
4. Bujar Pira, anëtar rezerv
5. Haki Demolli, anëtar rezerv

Më 24.09.2021 znj. Sogojeva njoftoi AKA-në se për shkak të emërimit si Komisionere për Informim dhe Privatësi nuk mund të vazhdojë të jetë pjesë e KA-së në AKA, dhe më 11.11.2021 Kryetari i Komisionit të Ankesave z. Merovci dorëzoi në AKA dorëheqjen e tij nga pozita e kryetarit dhe nga anëtarësia e KA-së. Rrjedhimisht, nga 11 nëntori 2021 Komisioni i Ankesave në AKA ka në përbërje tre anëtarë.

7. SIGURIMI I BRENDSHËM I CILËSISË SË PUNËS SË AKA

AKA me përkrahjen e ofruar nga projekti “Përkrahja e AKA-së në përmbushjen disa rekomandimeve të ENQA”, nga Ambasada Amerikane dhe i zbatuar nga WUS Kosova, ka

¹⁶ <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/10/ilovepdf-merged.pdf>

¹⁷ <https://mpb.rks-gov.net/ap/desk/inc/media/FC95CB25-50B5-4385-A800-CB31810A35CC.pdf>

¹⁸ http://akreditimi-ks.org/docs/LawRegulation/Rregullorja_e_komisionit_te_ankesave.pdf

zhvilluar Manualin për vlerësimin e brendshëm të stafit i cili është mekanizëm që do të ndihmojë në menaxhimin dhe zhvillimin e personelit të punësuar në AKA.

Ky manual bazohet në procesin e menaxhimit të performancës dhe shërben për qëllime administrative dhe zhvillimore. Qëllimi i këtij manuali është që të ofrojë udhëzime për zhvillimin e procesit të vlerësimit të performancës së stafit, proces ky që do të zbatohet nga AKA. Me ndihmën e këtij manuali AKA është e përkushtuar që të përkrah secilin anëtar të stafit të vet që të zhvillojë potencialin e tij dhe të arrijë qëllimet personale, të cilat nga ana tjetër do të ndihmojnë AKA-në në arritjen e objektivave të saj.

8. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR, PARTNERITETI DHE PROJEKTET

AKA është pjesë e rrjeteve ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe vazhdon të jetë edhe për vitin 2021.




Figura 6: Anëtarësimi dhe bashkëpunimi i AKA me partnerët dhe rrjetet ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë vazhdon edhe për vitin 2021

Figura 7, ilustron zhvillimin e AKA-se në mënyre kronologjike përgjatë dekadës së fundit, dhe për më shumë specifikon marrëveshjet e arritura përkatësisht anëtarësimin në rrjetet ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Për më shumë, brenda saj është theksuar edhe përjashtimi ENQA¹⁹ (2018) dhe EQAR (2019).

Viti 2021 AKA vazhdon të jetë:

- Anëtare të Rrjetit të Agjencive për sigurimin e Cilësisë në Evropën Qendrore dhe

¹⁹ ENQA, <https://www.enqa.eu/review-database/external-review-report-of-kaa-2/>

Lindore-CEENQA²⁰.

- Anëtare e INQAAHE²¹, Rrjeti Ndërkombëtar i Agjencive për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë
- Bashkëpunim me Agjencinë e Akreditimit të Maqedonisë Veriore (MV).
- Marrëveshje joformale me Agjencinë shqiptare të akreditimit për shkëmbimin e ekspertëve ndërkombëtar të vlerësimit

9. AKTIVITETE KRYESORE TË AGJENCISË E AKREDITIMIT

9.1 AKA ka përfunduar me sukses proceset e akreditimit për 239 programe studimore

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), gjatë këtij vitit 2021 ka arritur të përfundojë me sukses procesin e akreditimit për 239 programe akademike dhe 9 procese të akreditimit në nivel të institucioneve të arsimit të lartë. Prej 239 programeve, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, duke u bazuar në rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtar, për 199 raporte/vendime merr vendim pozitive për akreditim, ndërsa për 40 programe të tjera merr vendim që të mos akreditohen (Shih Figurën 8).



Figura 7: Vendimet e Këshilli Shtetëror të Cilësisë për 239 programet akademike

Përkundër shumë vështirësive që ka paraqitur pandemia COVID-19, ekipi i AKA-së arriti të kryejë të gjitha vizitat në terren brenda afatit ligjor, dhe i ka mundur Këshillin Shtetëror të Cilësisë (KShC) që të marrë vendimet për akreditim (ose refuzim) me kohë. Vizitat në terren janë zhvilluar nga ekspertët ndërkombëtarë në distancë (online) por ekipi i AKA-së së bashku me drejtorin kanë qenë prezentë fizikisht në çdo proces të vlerësimit të jashtëm dhe kanë bërë verifikimin e të gjithë personave që kanë qenë të përfshirë në akreditim, duke verifikuar fizikisht të gjitha informatat, dokumentet dhe videot të cilat u janë prezantuar ekspertëve ndërkombëtarë.

²⁰ Central and Eastern European Network of Quality Assurance Agencies in Higher Education. <https://www.ceenqa.org/>

²¹ The International Network for Quality Assurance Agencies in Higher Education (INQAAHE) <https://www.inqaahe.org/>

Ekspertët ndërkombëtarë të angazhuar në procesin e vlerësimit kanë konfirmuar se gjatë vitit 2021 kanë parë zhvillime shumë pozitive në cilësinë e arsimit të lartë në Kosovë.

Gjatë procesit të akreditimit AKA nuk ka pranuar asnjë ankesë nga asnjë institucion i arsimit të lartë, lidhur me procesin e vlerësimit të jashtëm. Ankesat si rëndom kanë ardhur pasi që janë dorëzuar draftet e raporteve të ekspertëve ndërkombëtarë, që në disa raste kanë qenë negative për akreditim të programeve të studimit.

Vlen të theksohet se procesi i akreditimit në Kosovë është vlerësuar pozitivisht në raportin e Komisionit Evropian për Kosovën, për më shumë është vlerësuar pozitivisht gjatë takimeve të realizuara me drejtoreshën e Asociacionit Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe Rrjeti i Agjencive të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë të Evropës Qendrore dhe Lindore (CEENQA). Prosesi i akreditimit në Kosovë është vlerësuar pozitivisht edhe nga monitoruesit vendorë dhe nga donatorët ndërkombëtarë.

9.2 Angazhohen 81 ekspertë ndërkombëtarë për vlerësim

Konform legjislacionit në fuqi, Kosova është i vetmi vend në rajon që i gjithë procesi i vlerësimit të jashtëm të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit zbatohet nga ekspertët ndërkombëtarë.

Procesi i akreditimit gjatë vitit 2021 përfshiu 81 ekspertë eminentë evropianë në fushat përkatëse të studimit (Shih Aneksin 2 – Lista e eksperteve).

Gjatë këtij procesi AKA ka zbatuar rekomandimin e ENQA, për përfshirjen e studentëve ekspertë në proces të akreditimit.

Të gjitha draftet e raporteve të ekspertëve ndërkombëtarë, u janë dërguar institucioneve të arsimit të lartë për komentim, para se të dërgohen në KShC për shqyrtim dhe proces të vendimmarrjes.

9.3 Aprovimi i Planit Strategjik të AKA-së 2021-2025

Këshilli Shtetëror i Cilësisë me përkushtimin maksimal dhe punën intensive ka aprovuar Planin Strategjik të AKA-së 2021-2025 në mbledhjen e mbajtur më 18 dhjetor 2021.

Plani Strategjik pesëvjeçar i AKA-së ka këto objektiva:

- a) Rikthimi i anëtarësisë së AKA-së në Asociacionin Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR);
- b) Kornizë e konsoliduar ligjore që garanton pavarësi institucionale dhe financiare të AKA-së në kryerjen e proceseve të sigurimit të jashtëm të cilësisë;
- c) Sistem i avancuar i menaxhimit dhe administrimit të AKA-së përmes rritjes së kapaciteteve fizike dhe profesionale;
- d) Përmirësimi i cilësisë në sektorin e arsimit të lartë përmes procedurave efikase dhe efektive të akreditimit dhe monitorimit;
- e) Digjitalizimi i avancuar i procedurave të AKA-së për një menaxhim efektiv të informatave dhe të dhënave të procedurave të vlerësimit të jashtëm.

Plani Strategjik i AKA-së është hartuar fillimisht nga stafi i brendshëm, më pastaj janë angazhuar 4 ekspertë vendorë dhe në fund, me përkrahjen e Projektit HERAS Plus, është angazhuar një ekspert gjerman për të verifikuar nëse plani strategjik është në pajtim me standardet evropiane dhe rekomandimet e ENQA.

Në përpilimin e Planit Strategjik ka pas një gjithëpërfshirje të të gjithë akterëve të arsimit të lartë (shih Aneksin 3 – Plani Strategjike i AKA-së 2021-2025).

9.4 Binjakëzimi ndërmjet Agjencive të Akreditimit të Kosovës dhe Austrisë

Me përkrahjen e projektit HERAS Plus, i financuar nga Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar (ADA) e Austrisë, Agjencia e Kosovës për Akreditim është binjakëzuar me Agjencinë e homologe Austriake për Sigurimin e Cilësisë dhe Akreditimin.

Ky projekt rrit bashkëpunimin në fushën e arsimit ndërmjet Kosovës dhe Austrisë. Përfituesit kryesor i këtij projekti do të jenë AKA dhe të gjitha palët në arsimin e lartë në Kosovë, duke përfshirë institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat të cilat kanë mijëra studentë dhe staf mësimdhënës. Përmirësimi i politikave dhe rritja e kapaciteteve të AKA-së ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e arsimit të lartë në Kosovë. Përmes implementimit të Standardeve dhe Udhëzimeve Evropiane (ESG) nga Kosova, shkëmbimi akademik i studentëve dhe stafit akademik bëhet shumë më i lehtë. Me zbatimin e standardeve ESG, krijohen hapësira për të lehtësuar integrimin e sistemit arsimor të Kosovës në BE, si dhe krijohen subjekte për njohjen e diplomave të studentëve kosovarë në vendet e BE-së.

Projekti i binjakëzimit synon shkëmbimin e përvojave austriake për AKA-në, përmes vizitave të ndërsjella, konferencave, trajnimeve dhe konsultimeve në fushën e zbatimit të standardeve ESG. Stafi i AKA-së do të vizitojë Agjencinë Austriake të Akreditimit dhe partnerët austriakë do të vizitojnë gjithashtu Kosovën, ku do të shkëmbejnë përvojat dhe praktikat më të mira të menaxhimit të institucioneve, menaxhimit të procesit, sigurimit të cilësisë dhe mbikëqyrjes së rezultateve. Shkëmbimet do të bëhen në të gjitha nivelet që lidhen me cilësinë në arsimin e lartë.

Projekti do të fokusohet në hartimin e metodologjive për procesin e akreditimit dhe zbatimit (vendimmarrjes) raportimit dhe procesit të ankimimit në përputhje me Standardet dhe Udhëzimet Evropiane (ESG).

Pjesë e projektit është edhe përkrahja e AQ Austria për AKA-në në përgatitjen për rikthim në ENQA dhe EQAR (Shih Aneksin 4 - Marreveshja me AQ Austria).

9.5 Studimi i fizibilitetit për dixhitalizimin dhe automatizimin e proceseve në AKA

Me mbështetjen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë – Projekti Fulbright, një anëtar të KSHC-se dhe një zyrtar të AKA-se, më 25 nëntor 2021, ka finalizuar projektin e zbatimit të studimit të fizibilitetit për dixhitalizimin e përgjithshëm të proceseve.

Ky projekt do të kontribuojë në dixhitalizimin dhe automatizimin e të gjitha proceseve në AKA dhe do të mundësojë rritjen e transparencës për publikun.

Për më shumë anëtarja e KSHC-se, Krenare Pireva Nuci ka dorëzuar termat e referencës të cilat përmbajnë kërkesat e specifikimeve softuerike për digjitalizimin dhe automatizimin, dokument ky që planifikohet të zbatohet gjatë vitit 2022 dhe do të vihet në funksion për të gjithë akterët e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.

Zbatimi i këtij projekti do të bëhet me fondet e AKA-së dhe donatorëve ndërkombëtarë, për të rritur transparencës, llogaridhënien dhe kënaqësinë e të gjitha palëve të interesuara, përfshirë studentët, komunitetin akademik, organizatat e shoqërisë civile dhe publikun e gjerë.

Ideja është që të integrohen të gjitha këto pjesë në një platformë të vetme ku procesi i akreditimit do të dixhitalizohet plotësisht (e ngjashëm me sistemet e bazuara në raste). Portugalia është një nga vendet e BE-së që ka pasur shumë sukses në dixhitalizimin e akreditimit. AKA po planifikon ta sjellë këtë model në Kosovë.

AKA ka planifikuar buxhetin prej 50 mijë euro për vitin 2022, ndërsa ka marrë premtime nga donatorët që do të na ndihmojnë në finalizimin e dixhitalizimit.

Në këtë projekt kanë qenë të përfshirë të gjithë akterët e arsimit të lartë. Rekomandimet e tyre janë analizuar dhe disa nga ato janë përfshirë në dokumentin final (Shih Aneksin 5 - Plani i Fizibilitetit)

9.6 Nga KShC është aprovuar metodologjia për analiza tematike

Me financimin e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Organizata WUS Kosova ka zbatuar projektin “Përkrahja e Agjencisë së Kosovës për Akreditim për plotësimin e disa rekomandimeve të ENQA”.

Projekti është zbatuar në periudhën shtator 2020 – Shtator 2021.

Pika kryesore e këtij projekti ka qenë zbatimi i rekomandimit të ENQA për krijimin e Metodologjisë për analiza tematike. AKA ka përveç krijimit të Metodologjisë së analizës tematike, ka zbatuar edhe dy analiza tematike:

- a) Përgatitja e të diplomuarve kosovarë për tregun e punës – Perspektiva e punëdhënësit dhe e të diplomuarve;
- b) Analiza Tematike për Akreditimin Institucional për IAL.

Pjesë e këtij projekti ka qenë edhe trajnimi i stafit të AKA-së për të zbatuar në të ardhmen analiza tematike të temave me interes të sistemit të arsimit të lartë.

Në këtë projekt kanë qenë të përfshirë të gjithë akterët e arsimit të lartë në Kosovë dhe komuniteti i biznesit (Shih Aneksin 6 – [Metodologjinë e analizës tematike](#), Aneksin 7 - [Analiza tematike 1](#), Aneksi 8 - [Analiza tematike 2](#))

9.7 Nga KShC është aprovuar Udhëzuesi për Vlerësim të Brendshëm të stafit të AKA

Me përkrahjen e projektit të WUS Kosova, KShC ka aprovuar Udhëzuesin për Vlerësimin e Brendshëm të personelit të AKA-së, i cili ka qenë edhe rekomandim i ENQA.

Qëllimi i këtij udhëzuesi është menaxhimi i performancës si një proces i vazhdueshëm organizativ që realizohet për të maksimizuar produktivitetin e stafit me qëllim të përgjithshëm të përmirësimit të efektivitetit të institucionit. Ky udhëzues përputhet me qëllimet strategjike të AKA-së dhe kërkon komunikim të hapur ndërmjet menaxherëve dhe stafit (Shih Aneksin 9 - Manuali për Vlerësimin e Stafit të AKA).

9.8 Nga KShC është aprovuar Metodologjia e Monitorimit dhe procedurave pasakredituese

KShC ka aprovuar dokumentin Metodologjia e Monitorimit dhe procedurave pasakredituese. Deri më tani AKA nuk ka pas një mekanizëm të monitorimit dhe as të procedurave pas akredituese dhe kjo ka qenë ngecje e madhe për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë.

Dokumenti do të shërbejë si udhërrëfyes për AKA-në, institucionet e arsimit të lartë, ekspertët ndërkombëtarë si dhe publikun e gjerë për zbatimin e procedurave të drejta dhe transparente pas akredituese dhe të monitorimit.

Dokumenti përmbush Standardin 2.3 të Udhëzuesve Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG) i cili kërkon që agjencitë e sigurimit të cilësisë të përmyllin ciklin e akreditimit me procedura pas akredituese të cilat kanë për qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë.

Për hartimin e këtij projekti kanë qenë të përfshirë të gjithë akterët e arsimit të lartë, nëpërmes konferencave, intervistave, tryezave dhe dëgjimit publik.

Ky dokument është realizuar me përkrahjen e Projektit QAIN, i financuar nga ADA Austriake. Dokumenti është pikë e rendit të ditës për aprovim në mbledhjen e KShC-së më 18 janar 2022 (Shih Aneksin 10 - Metodologjia e Monitorimit).

9.9 Vërtetimet për akreditim tani lëshohen online

Me financimin e Ambasadës së SHBA-së, AKA në verën e vitit 2021 ka digjitalizuar lëshimin e konfirmimeve për akreditim. Të gjithë studentët dhe të diplomuarit që kanë nevojë të pajisen me vërtetime për akreditimin e programeve të tyre të studimeve, tani mund t'i nxjerrin ato online, pa pasur nevojë që të vijnë fizikisht në Agjencinë e Akreditimit.

Kjo është një arritje e madhe, sepse përveç rritjes së sigurisë së lëshimit të dokumentacionit, dhe eliminimit të gjitha mundësive për gabime njerëzore, kjo platformë rrit edhe besueshmërinë e dokumenteve të lëshuara nga Agjencia e Akreditimit tek partnerët ndërkombëtarë.

Çdo vërtetim i nxjerrë në mënyrë elektronike, të gjitha palëve ju mundëson verifikimin elektronik në linkun e veçantë. Të gjitha agjencitë homologe të AKA-së në Evropë dhe më gjerë, tani kanë qasje direkte në verifikimin e dokumenteve të lëshuara nga AKA.

Ky shërbim ka kaluar të gjitha standardet e sigurisë kibernetike nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (Shih Aneksin 11 - Aplikacioni për vërtetime online).

9.10 Nga KShC është aprovuar Manuali për ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit

Agjencia e Akreditimit e Kosovës (AKA) me përkrahjen e Projektit HERAS Plus ka hartuar një Manual Informimi dhe Trajnimi për të siguruar udhëzime të bazuara në praktikë për ekspertët ndërkombëtarë të vlerësimit të cilët kryejnë një vlerësim të jashtëm të institucioneve të arsimit të lartë (IAL) në Kosovë në emër të Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (AKA).

Manuali është jetik pasi Agjencia do ta përdorë atë për t'u ofruar ekspertëve trajnim zyrtar në temat përkatëse të procesit të akreditimit dhe kuptimin kontekstual të peizazhit të arsimit të lartë dhe proceseve të lidhura me to.

Projekti ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimeve të Agjencisë së Akreditimit për vlerësimin e jashtëm të institucioneve të arsimit të lartë, por gjithashtu plotëson një nga kriteret për kthimin tonë në ENQA dhe EQAR (Shih Aneksin 12 - [Manualin për eksperte ndërkombëtare](#)).

9.11 Është lansuar ueb faqja e re e AKA-së dhe profili zyrtar në Facebook

Me financimin nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës është zhvilluar dhe lansuar ueb faqja e re e AKA-së.

Faqja është në tri gjuhë, shqip, anglisht dhe serbisht. Në ueb faqe publikohen të gjitha vendimet dhe zhvillimet në AKA, me cka rritet transparenca e AKA-së

AKA ka lansuar edhe profilin zyrtar në Facebook, ku publikohen të gjitha lajmet, njoftimet dhe zhvillimet në AKA ([Shiko ueb faqen e re](#), [Shiko profilin zyrtar në Facebook](#)).

9.12. AShI garanton sigurinë kibernetike të AKA-së

Krahas krijimit të ueb faqes së re, është bërë edhe transferi i serverëve të AKA-së tek Agjencia Shtetërore e Informacionit (AShI). Tani e tutje ueb faqja e Agjencisë, lëshimi i vërtetimeve elektronike për akreditim dhe platforma e-Akreditimi ku ruan të dhënat e mbi 4000 personave staf akademik, garantohet nga AShI.

9.13 Ndërlidhja e Platformës e-Akreditimi me Administratën Tatimore

AKA ka në pronësi platformën elektronike E-Akreditimi e cila ruan të gjitha të dhënat e stafit akademik në Republikën e Kosovës. Gjatë vitit 2021 AKA ka lidhur këtë platformë me serverët e Administratës Tatimore të Kosovës, për të verifikuar nëse stafi akademik ka më shumë se një vend pune me orar të plotë.

Kjo platformë ka eliminuar dukurinë e anagzhimit të stafit akademik në më shumë se dy vende me orar të plotë të punës ([Shih platformën elektronike](#))

9.14 Publikohen të gjitha vendimet dhe raportet e ekspertëve ndërkombëtarë

Me qëllim të transparencës së plotë dhe llogaridhënies ndaj publikut, Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) ka publikuar më 13.08.2021 të gjitha vendimet dhe raportet përfundimtare të ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit.

Transparenca dhe llogaridhënia e plotë, janë një nga rekomandimet e ENQA, të cilin AKA po e zbaton në plotni ([Shih vendimet](#)).

9.15 AKA publikon listat me programet e akredituara dhe spotin informues

Agjencia e Kosovës për Akreditim ka publikuar më 06.08.2021 listën me programet e akredituara në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës për vitin e ri akademik 2021/2022.

Në listën e vendimeve me programet e akredituara përfshihen vendimet e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) të datës 27.07.2021, por edhe programet që kanë pasur akreditim të mëhershëm.

Të gjithë studentët e rinj janë njoftuar, se asnjë program akademik i cili nuk ndodhet në këtë listë, nuk është valid në Republikën e Kosovës.

Gjithashtu me buxhetin e vet AKA ka publikuar edhe një spot publicitar i cili i këshillon studentët e rinj që para se të vendosin për aplikim në ndonjërin nga IAL-të, të vizitojnë faqen e AKA-së ([Shih Aneksin 13 - Programet e akredituara](#), [Shiko spotin](#))

10. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE E PARTNERË VENDORË

10.1 Miratimi i Ligjit për AKA-në në Qeveri

Përfaqësues të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) dhe Agjencisë së Akreditimit të Kosovës marrin pjesë aktive në hartimin e ligjit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim. Ky Projektligj e rregullon statusin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim si agjenci rregullore në proceset dhe përgjegjësitë e akreditimit, riakreditimit, validimit dhe monitorimit, me qëllim të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës. Në hartimin e këtij projektligji janë përfshirë të gjithë akterët relevantë, ekspertë nga MASHTI, Agjencia e Akreditimit, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, përfaqësues të komunitetit akademik, donatorëve dhe të shoqërisë civile.

Ky version i Projektligjit siguron pavarësinë e Agjencisë së Akreditimit si dhe zbatimin e standardeve evropiane të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.

Me miratimin e këtij ligji po plotësohet edhe kriteri i fundit për ri aplikim të AKA-së për rikthim në ENQA dhe EQAR, prioritet ky numër një në planin e veprimit nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë (Shih Aneksin 14 - Dokumentin Plani i Veprimit i hartuar nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë)

10.2 Plani Dinamik për kthim në ENQA dhe EQAR

KShC dhe AKA kane përpiluar dhe dorëzuar në MASHTI Planin Dinamik për Kthimin në ENQA dhe EQAR.

Sipas këtij Plani nga 13 rekomandimet kryesore për kthim në ENQA dhe EQAR tashmë janë plotësuar në masën mbi 90%. Pasi që të aprovet Ligji për AKA-në në Kuvend dhe të nxirren aktet nënligjore, llogaritet se plotësohen kriteret në nivelin 100%.

10.3 Vizitat e KShC dhe AKA në të gjitha institucionet e arsimit të lartë

Kryetarja e Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), vizituan të gjitha institucionet e akredituara të arsimit të lartë në Kosovë, vizita këto te rekomanduara nga ENQA. Gjatë vizitave, përveç menaxhmentit janë zhvilluar takime edhe me përfaqësuesit e studentëve dhe komunitetin akademik.

Nga drejtuesit e institucioneve të arsimit të lartë, komuniteti akademik dhe studentët janë marrë rekomandime konkrete për ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë.

Përfshirja e IAL-ve në procesin e vendimmarrjes është edhe një nga kriteret për kthim në ENQA dhe EQAR ([Shiko lajmet nga vizitat në terren](#)).

10.4 Ndërtesa e re e AKA-së

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka vendosur që objekti i ri publik, në lokacionin “Prishtina e Re”, t’i dedikohet AKA-së. Objekti është modern me mbi 1000 metra katrorë, dhe i plotëson të gjitha nevojat e AKA-së.

Ndërtimi i selisë së re është planifikuar të përfundojë në fillim të vitit 2022 dhe pritet që AKA të kalojë në objektin e ri deri në fund të vitit 2022.

Me këtë ndërtesë AKA plotëson kriterin e ENQA për “hapësira të mjaftueshme për stafin e Agjencisë”.

10.5 Rekrutimi i stafit

Me rastin e ndryshimit të Ligjit për Zyrarët Publikë kanë ndryshuar edhe procedurat e rekrutimit të personelit. Duke qenë se stafi i AKA-së janë nëpunës civilë, është pritur derisa janë krijuar procedurat e reja të rekrutimit në përputhje me ligjin e ri. AKA aktualisht ka 9 staf, ndërsa ka të aprovuar gjithsej 32 staf. Në vitin 2021 është punësuar një zyrtar i IT-së.

10.6 Bashkëpunimi me shoqërinë civile

AKA ka të nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me projektin QAINTE, i cili i mundëson organizatës vendore ORCA që të bëjë monitorimin e punës së Agjencisë dhe KShC-së.

Monitorimin e punës së KShC-së e bën edhe organizata BIRN.

Në të gjitha raportet e këtyre dy organizatave figurojnë se AKA është shumë transparente dhe llogaridhënëse para publikut ([Shiko Aneksin 15 - Raportin e ORCA për AKA-në](#))

10.7 Bashkëpunimi me Avokaturën Shtetërore

Avokatura Shtetërore e Kosovës më 11.11.2021 ka konstatuar se AKA po respekton plotësisht kornizën ligjore në Republikën e Kosovës dhe nuk rrezikohet nga asnjë kontest gjyqësor.

Avokatura Shtetërore është zotuar se do të përkrahë plotësisht Agjencinë e Akreditimit, jo vetëm për mbrojtjen juridike nëpër gjykata, por edhe për përpilimin e akteve juridike, në mënyrë që ato të jenë plotësisht në harmoni me legjislacionin në fuqi dhe të mos mund të kontestohen nëpër gjykata.

Avokatura i ka mirëpritur masat e ndërmarra nga AKA për të garantuar siguri juridike ndaj të gjitha palëve. Me përkrahjen e deritanishme e Avokaturës Shtetërore Agjencia e Akreditimit të mos humb asnjë rast nëpër gjykata.

Avokatura Shtetërore dhe Agjencia e Akreditimit kanë caktuar personat kontaktues në mënyrë që të lehtësohet bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve. Avokatura ka shprehur gatishmëri për të përkrahur AKA-në në rastet e përgatitjes së padive nëpër gjykata kur evidentohen shkeljet në sistemin e arsimit të lartë.

11. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE E PARTNERË NDËRKOMBËTARË

11.1 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, i tetorit të viti 2021 në pjesën për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) është i saktë, shumë pozitiv dhe inkurajues për punën e AKA-së dhe jep shpresë për kthimin në ENQA dhe EQAR.

Megjithëse i prekur nga pandemia, Komisioni Evropian vlerësoi se, citat: *“Agjencia arriti të përfundojë ciklin e plotë të akreditimit për vitin akademik 2021-2022, duke ulur numrin e programeve dhe institucioneve, bazuar në kriteret e cilësisë”*.

Kjo tregon se AKA i zbaton plotësisht standardet evropiane të cilësisë, pasi në procesin e akreditimit gjatë këtij viti janë angazhuar 81 ekspertë eminentë ndërkombëtarë.

Edhe në raportin e 23 shkurt 2021 në kuadër të Procesit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Komisioni Evropian e vlerëson shumë pozitivisht punën e AKA-së, duke thënë se *“megjithëse në kushte pandemie procesi i akreditimit është menaxhuar shumë mirë”*.

Komisioni Evropian e vlerëson punën e AKA-së për përmbushjen e kriteve për kthimin në ENQA dhe EQAR kur thotë *“AKA vazhdoi përpjekjet për të rikthyer anëtarësimin”*.

Komisioni Evropian ka vërtetuar edhe raportet e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë, të cilat e kanë vlerësuar shumë pozitivisht punën e Agjencisë së Akreditimit ([Shiko raportin](#)).

11.2 Rishikimi i standardeve në nivelin bachelor dhe master

Me financimin nga ADA Austriake, Projekti HERAS Plus po zbaton projektin e rishikimit të standardeve në nivelin bachelor dhe master.

Në këtë projekt janë të përfshira MASHTI, KShC, AKA, IAL-të, ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, përfaqësues të donatorëve, shoqërisë civile, komuniteti akademik, studentët etj.

Janë mbajtur tryeza dhe konferenca me të gjithë akterët e arsimit të lartë. Tani ekziston një draft i rishikuar i standardeve i cili kalon nëpër procedura të rishikimit publik. Deri në prill të vitit 2022 pritet që të hyjnë në fuqi standardet e reja, ndërsa për 6 muaj do të mbahen trajnime me IAL-të për tu përgatitur për aplikimin e tyre në tetor të vitit 2022.

11.3 AKA fiton grant nga Ambasada Amerikane për përfshirjen e studentëve në vendimmarrje

Agjencia e Akreditimit, më 8 tetor 2021, është shpallur fituese e grantit nga Ambasada Amerikane në Kosovë. Projekti i financuar synon të rrisë përfshirjen e studentëve në procesin e sigurimit të cilësisë, duke krijuar një ndikim të drejtpërdrejtë në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë dhe duke i kthyer studentët në palë të rëndësishme të interesit brenda sistemit.

11.4 CEENQA prezanton suksesin e AKA-së në procesin e digjitalizimit të shërbimeve

Në numrin e dhjetorit të revistës së Rrjetit të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë të Evropës Qendrore dhe Lindore (CEENQA), është prezantuar puna e suksesshme e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) në finalizimin e projektit zbatues për digjitalizimin e përgjithshëm të proceseve në AKA.

Krahas agjencive simotra të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, në faqen 13 të kësaj reviste, AKA-Kosova prezantohet me titullin “*Është finalizuar studimi i fizibilitetit për dixhitalizimin dhe automatizimin e proceseve në AKA*”. Kjo është hera e tretë brenda një viti që CEENQA prezanton Kosovën dhe Agjencinë e saj për Akreditim si storie të suksesit për ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë.

Në dhjetorin e vitit 2020 dhe në korrikun e vitit 2021, CEENQA e ka prezantuar AKA gjithashtu me vlerësime shumë pozitive.

Kosova është anëtare me të drejta të plota në CEENQA ([Shiko Aneksin 16 - Njoftimin CEENQA](#))

11.5 AKA dhe Asociacioni amerikan ATMAE bashkëpunojnë për nxitjen e cilësisë në arsimin e lartë

Me ftesë të agjencisë homologe amerikane – Asociacionit për Teknologji, Menaxhment dhe Inxhinieri Aplikative (ATMAE), e cila bën akreditimin e të gjitha programeve akademike në fushën e teknologjisë dhe inxhinierisë në ShBA, delegacioni i Agjencisë së

Kosovës për Akreditim (AKA) dhe MASHTI-it (Qendra NARIC), në nëntor 2021 qëndruan për një javë në Orlando të Floridas në SHBA.

Gjatë takimeve me homologët amerikanë, ATMAE ka shprehur gatishmërinë për të përkrahur AKA-në me ekspertë eminentë për të nxitur zhvillimin e programeve akademike në fushën e teknologjisë dhe inxhinierisë në Kosovë.

Drejtimesit e ATMAE kanë shprehur gatishmërinë që stafi i AKA-së të përfshihet, në cilësinë e ekspertëve të jashtëm, në procesin e akreditimit të programeve akademike në SbBA. Kjo është një dëshmi e fortë se homologët amerikanë besojnë në vlerat, integritetin akademik dhe institucional që përfaqëson AKA-ja.

Delegacioni i Kosovës mori pjesë në mbledhjet e Bordit dhe manaxhmentit të ATMAE, në disa konferenca shkencore dhe inovative, në panairin e universiteteve më të njohura amerikane dhe në garën e studentëve në fushën e robotikës.

Në ceremoninë kryesore ATMAE i ka ndarë delegacionit nga Kosova një mirënjohje “për bashkëpunim dhe akreditim të suksesshëm”.

11.6 AKA mbështet nga QAINTE për hartimin e KSAC për lehtësimin e klasifikimit të fushave të studimit

Projekti i financuar nga QAINTE synon të harton Kodet e fushave të Studimit për Kosovë (deri në 3 nivele), dokument ky i bazuar në Kodet e fushave ERASMUS, dhe përshtatjen e tyre në kontekstin e Kosovës. Përmes këtij hartuesi Institucionet e Arsimit të Lartë do të kenë mundësinë e rishikimit të përputhjes së bartësve të programit me fushat e caktuara. Një decentralizim i këtij procesi do të ndihmonte IAL-të të vetë-kontrollojnë përputhjen e programeve studimore me bartësit e programeve të tyre. Pas diskutimit të brendshëm dhe finalizimit të dokumentit, i njëjti do shpërndahet për diskutim publik para se të aprovohet nga KSHC.

ANEKSET

ANEKS 1 - PROCESI I VLERËSIMIT 2021

ANEKS 2 - EKSPERTET E ANGAZHUAR NE AKREDITIM

ANEKS 3 - PLANI STRATEGJIK-I-AKA-2021-2025 DHJETOR-2021

ANEKS 4 - MARRËVESHJA ME AQ AUSTRIA

ANEKS 5 - PLANI I FIZIBILITETIT

ANEKS 6 - METODOLOGJIA E ANALIZËS TEMATIKE

ANEKS 7 - ANALIZA TEMATIKE PËR AKREDITIM INSTITUCIONAL

ANEKS 8 - ANALIZA TEMATIKE PËR TREGUN E PUNËS

ANEKS 9 - MANUALI PËR VLERËSIMIN E STAFIT TE AKA

ANEKS 10 - METODOLOGJIA E MONITORIMIT

ANEKS 11 - APLIKACIONI PËR VËRTETIME ONLINE

ANEKS 12 - MANUALI PËR EKSPERT NDËRKOMBËTARE

ANEKS 13 - PROGRAMET E AKREDITUARA 2021-2022

ANEKS 14 - PLANI DINAMIK PËR KTHIM NE ENQA DHE EQAR

ANEKS 15 - RAPORTI I ORCA PËR KSHC

ANEKS 16 - REVISTA E CEENQA DHJETOR 2021